



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2021:102665

Datë: 30.04.2024

Numri i dokumentit: 05638057

C.nr.648/2021

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË VUSHTRRI – Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin Leotrim Gashi, në çështjen juridike kontestimore të paditëseve S.S me vendbanim në M, R.S, me vendbanim në V, B.Gj, me vendbanim në V, A.Z, me vendbanim në V dhe F.B, me vendbanim në V, të cilët i përfaqësojnë zyra e avokatëve F.G dhe K.F me seli në P, rruga “F.A”, kundër të paditurës Komuna e Vushtrrisë-Drejtoria për Arsim, të cilën e përfaqëson Bastri Duraku, lidhur me kompensimin e shpenzimeve të ushqimit për ditët e pranisë në punë, me vlerë të objektit të kontestit 2,990.00 euro, jashtë seancës, me datë 29.04.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

**I. APROVOHET PJESËRISHT** si e bazuar kërkesëpadia e paditësve S.S, R.S, B.Gj, A.Z dhe F.B, si dhe **DETYROHET** e paditura Komuna e Vushtrrisë-Drejtoria për Arsim, që në emër të kompensimit të shpenzimeve të ushqimit-shujtave për ditët e pranisë në punë, t’ia kompensoj:

- Paditësit S.S për periudhën kohore nga data 15.07.2019 e deri me datë 15.03.2021, për 250 ditë të pranisë në punë, shumën 500.00 euro.
- Paditësit R.S për periudhën kohore nga data 15.07.2019 e deri me datë 15.03.2021, për 250 ditë të pranisë në punë, shumën 500.00 euro.
- Paditëses B.Gj për periudhën kohore nga data 15.07.2019 e deri me datë 15.03.2021, për 250 ditë të pranisë në punë, shumën 500.00 euro.
- Paditësit A.Z për periudhën kohore nga data 15.07.2019 e deri me datë 15.03.2021, për 250 ditë të pranisë në punë, shumën 500.00 euro.
- Paditëses F.B për periudhën kohore nga data 15.07.2019 e deri me datë 15.03.2021, për 245 ditë pune, shumën 490.00 euro.

Të gjitha këto me kamatë ligjore prej 8% në vit, duke e llogaritur nga data e paraqitjes së padisë me datë 27.05.2021, e deri në pagesën definitive, në afat prej shtatë (7) ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

- II. REFUZOHET SI E PABAZUAR** pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësve S.S, R.S, B.Gj, A.Z dhe F.B, me të cilën kanë kërkuar që të **DETYROHET** e paditura Komuna e Vushtrrisë-Drejtoria për Arsim, që në emër të kompensimit për ushqimin-shujtën ditore për periudhën kohore nga data 16.03.2020 e deri më 29.05.2020, secili prej tyre të kompensohen edhe në shumën prej 100.00 euro, për 50 ditë mësim online.
- I. DETYROHET** e paditura Komuna e Vushtrrisë-Drejtoria për Arsim, që paditëseve S.S, R.S, B.Gj, A.Z dhe F.B, në emër të shpenzimeve të procedurës, të ia paguaj shumën në vlerë prej 352.00 euro, në afat prej shtatë (7) ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

### A r s y e t i m

Paditësit me datë 27.05.2021, përmes përfaqësuesve të tyre të autorizuar, kanë ushtruar padi në këtë gjykatë kundër të paditurës Komuna e Vushtrrisë-Drejtoria e Arsimit, me objekt kontesti për kompensim të ushqimit-shujtave për ditët e pranisë në punë.

#### *Pretendimet e palëve*

Paditësit S.S, R.S, B.Gj dhe A.Z, përmes padisë kanë kërkuar që gjykata ta detyroj të paditurën që duke u bazuar në Kontratën Kolektive të Arsimit nr. 2056 e cila ka hyrë në fuqi me datë 18.04.2017 (Tani e tutje KKA) t'ia paguaj shpenzimet e ushqimit-shujtave për ditët e pranisë në punë në shumën prej dy (2) euro në ditë dhe atë për periudhën kohore nga data 15.07.2019 e deri me datë 15.03.2021, për 300 ditë pune, ku secilit prej tyre t'ia paguaj shumën në vlerë prej 600.00 euro, respektivisht paditësja F.B, gjatë kësaj periudhe kohore, për 295 ditë pune, ka kërkuar që të kompensohet në shumën prej 590.00 euro, të gjitha këto me kamatë ligjore prej 8% në vit, duke e llogaritur nga data e paraqitjes së padisë me datë 27.05.2021, e deri në pagesën definitive, në afat prej shtatë (7) ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Shpenzimet e procedurës i kanë kërkuar me precizimin e datës 18.03.2024.

Përmes përgjigjes në padi së të autorizuarit të së paditurës Basri Duraku, të datës 30.11.2023, e paditura ka kërkuar që gjykata ta refuzoj kërkesëpadinë e paditësve në tërësi si të pabazuar me arsyetimin se të paditurës i mungon legjitimacioni pasiv për të qenë palë në këtë procedurë kontestimore sepse ajo nuk ka qenë pjesëmarrëse në marrëdhëniet detyrimore dhe nuk ka marrë obligime për përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga KKA-ja por që këtë e kanë bërë Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) dhe Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës (SBASHK) të cilat nuk kanë përmbushur obligimet e kësaj Kontrate, për të siguruar mjete buxhetore për Komunitat. Përpos kësaj ka shtuar se padia dhe kërkesëpadia e paditësve është parashkruar pasi që Kontrata Kolektive e Arsimit është nënshkruar më 18.04.2017 dhe ka qenë në fuqi deri më datë 18.04.2020, konkretisht sipas mendimit juridik të Gjykatës Supreme

nr 40/2023, deri më datë 21.01.2021 dhe se e njëjta nuk ka efekt për asnjë kërkesë e cila lind pas kësaj date, ndërsa paditësit e ka paraqitur padinë në gjykatë pas këtij afati kur efektet Kontratës Kolektive të Arsimit kanë pushuar. E paditura këtë e bazon në nenin 90.4 të Ligjit të Punës sipas të cilit theksohet se "*Marrëveshja Kolektive mund të lidhet për një periudhë të caktuar me kohëzgjatje jo më shumë se tri (3) vjet*" nenit 87 të këtij ligji që ka paraparë që "*Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës*" dhe nenit 342 Të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve ku thuhet se "*Parashkrimi fillon të rrjedhë ditën e parë pas ditës kur kreditori të ketë pasur të drejtë të kërkojë përmbushjen e detyrimit, në qoftë se me ligj për raste të veçanta nuk është parashikuar diçka tjetër*". Ndërsa sa i përket shpenzimeve të procedurës ka theksuar që të njëjtat i bartin paditësit.

### *Provat*

Gjykata në këtë çështje juridike kontestimore me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike sipas propozimit të palëve ka administruar këto prova:

Kontrata e punës e lidhur në mes paditësit S.S dhe të paditurës, dhe Vërtetimi nr. 529 i datës 16.03.2021, i lëshuar nga Shkolla e Mesme Profesionale "Bahri Haxha" në Vushtri, për ditët e punës së paditësit S.S, Kontrata e punës e lidhur në mes paditësit R.S dhe të paditurës dhe Vërtetimi nr. 546 i datës 16.03.2021, i lëshuar nga Shkolla e Mesme Profesionale "Bahri Haxha" në Vushtri, për ditët e punës së paditësit R.S, Kontrata e punës e lidhur në mes paditëses B.Gj dhe të paditurës si dhe Vërtetimi nr. 514 i datës 16.03.2021, i lëshuar nga Shkolla e Mesme Profesionale "Bahri Haxha" në Vushtri, për ditët e punës së paditëses B.Gj, Kontrata e punës e lidhur në mes paditësit A.Z dhe të paditurës dhe Vërtetimi, nr. 502 i datës 16.03.2021, i lëshuar nga Shkolla e Mesme Profesionale "Bahri Haxha" në Vushtri, për ditët e punës së paditësit A.Z, Kontrata e punës e lidhur në mes paditësit F.B dhe të paditurës dhe Vërtetimi nr. 495 i datës 16.03.2021, i lëshuar nga Shkolla e Mesme Profesionale "Bahri Haxha" në Vushtri, për ditët e punës së paditësit F.B.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë dhe kërkesëpadisë, provave të propozuara si dhe përgjigjes në padi në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 398 të LPK-së, ka çmuar me kujdes dhe me ndërgjegje çdo provë veç e veç dhe të gjitha së bashku dhe ka gjetur se kërkesëpadija e paditësve është pjesërisht e themeltë andaj pa shqyrtim të çështjes, e aprovoi pjesërisht kërkesëpadinë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

### *Baza ligjore dhe vlerësimi përfundimtar i gjykatës*

Në mes palëve nuk ishte kontestues fakti se paditësit kanë qenë në marrëdhënie pune tek e paditura për gjatë kësaj periudhe kontestuese. Po ashtu nuk ishin kontestuese as ditët e pranisë në punë nga paditësit, këto të vërtetuara edhe nga vërtetimet për ditët e punës së paditësve, të cilave prova gjykata ia fali besimin e plotë duke u bazuar edhe në nenin 329.1, të LPK-së, në të cilin përcaktohet që "*Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti*

publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”, pasi janë lëshuar nga institucionet arsimore të së paditurës.

Kontestuese në mes palëve ishte fakti nëse pala e paditur ka legjitimitet pasiv në këtë çështje kontestimore dhe nëse kërkesëpadia e paditëseve është e parashkruar. Pra në këtë procedurë për gjykatën ishte e rëndësishme që ta vërtetoj bazën ligjore lidhur me kërkesëpadinë e paditëseve dhe besueshmërinë e saj me prova e po ashtu edhe pretendimet e palës së paditur se ajo nuk ka legjitimitet për të qenë palë në këtë procedurë dhe se kërkesëpadia e paditëseve është parashkruar.

Duhet theksuar se pavarësisht se paditësit kërkesëpadinë e tyre e kanë bazuar vetëm në KKA-në nr.2056, e datës 18.04.2017, duke marrë parasysht se sipas nenit 253.2 të LPK-së, gjykata nuk është e lidhur me bazën juridike të kërkesëpadiës, gjykata ka vendosur që e drejta e paditëseve për kompensimin në emër të ushqimit-shujtave për ditët e kaluara në punë për periudhën kohore nga 15.07.2019 e deri me datë 21.01.2021 si në dispozitivin I, të këtij aktgjykimi është e bazuar në KKA-në nr.2056, e datës 18.04.2017, pasi sipas Mendimit Juridik të Gjykatës Supreme nr. 214/2023, kjo Kontratë ka pasur efekt deri më 21.01.2021, kurse pas kësaj date e deri më 15.03.2021, kërkesëpadia e paditëseve është e bazuar në KKA-në nr.105, e datës 22.01.2021. Kjo ngase gjatë kësaj periudhe për të cilën e kanë kërkuar kompensimin paditësit kanë qenë në fuqi në periudhat e cekura më lartë, të dy Kontratat Kolektive. Mirëpo duhet theksuar po ashtu se kjo e drejtë është rregulluar në mënyrë identike nga të dy këto Kontrata Kolektive.

Me dispozitën e nenit 2.1.1 të KKA-së nr. 2056 dhe asaj nr. 105, është përcaktuar që *“Dispozitat e kësaj Kontrate Kolektive, janë të zbatueshme për të gjithë të punësuarit në të gjitha institucionet publike dhe private të Arsimit Parauniversitar (parashkollor, fillor, të mesëm të ultë dhe të mesëm të lartë, shkolla special e qendra të kompetencës) dhe institucionet e arsimit të lartë në mbarë territorin e Republikës së Kosovës, të cilët janë anëtarë të SBASHK-ut”,* kurse me pikën 1.2 të këtij neni të thuhet se *“Dispozitat e kësaj Kontrate Kolektive janë të zbatueshme për të gjithë punëdhënësit në sektorin e arsimit (komunal - DKA, KD të Universiteteve e institucioneve të arsimit të lartë, MASHT-in etj) në sektorin publik dhe institucionet edukativo – arsimore private në mbarë territorin e Republikës së Kosovës”.*

Sa i përket bazueshmërisë kërkesëpadiës së paditëseve, e njëjta rrjedh nga neni 35.7 i KKA-së nr.2056 dhe asaj nr. 105, sipas të cilit nen përcaktohet se *“Të punësuarve, u sigurohet kompensim për ushqime gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimeve të ushqimit në punë, për një ditë pune, është 2 (dy) euro, për të punësuarit të cilët kanë marrëdhënie pune primare në institucionet arsimore. Punëdhënësi i cili e ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve përmes restorantit, kuzhinës ose në një formë tjetër, nuk ka obligim pagese, të të punësuarve për ushqim.”*, prandaj gjykata ka vendosur që ta aprovoj pjesërisht kërkesëpadinë paditëseve si në dispozitivin I të këtij aktgjykimi.

Me Vërtetimet nr. 529, për paditësin S.S, nr. 546 për paditësin R.S, nr. 514 për paditësen B.Gj dhe nr. 502 për paditësin A.Z, për ditët e punës së paditësve, të lëshuara me datë 16.03.2021 nga Shkolla e Mesme Profesionale “Bahri Haxha” në Vushtrri, është vërtetuar se secili nga paditësit

e lartcekur gjatë periudhës kohore nga data 15.07.2019 e deri me datë 15.03.2021, kanë pasur nga 300 ditë pune, nga të cilat 250 ditë në vendin e punës dhe 50 ditë të tjera mësim online pa qenë në vendin e punës (në periudhën 16.03.2020 e deri më 29.05.2020) dhe në bazë të një kalkulimi të 250 ditëve të punës në vendin e punës, shumëzuar për vlerën prej dy (2) euro në ditë për shujtën ditore, rezulton se detyrimi i të paditurës ndaj secilit nga këta paditës (S.S, R.S, B.Gj dhe A.Z), në emër të kompensimit për ushqimin ditor-shujtave në punë, të jetë në shumën prej 500.00 euro.

Gjykata po ashtu aprovoi pjesërisht edhe kërkesëpadinë e paditëses F.B sepse ajo sipas Vërtetimit nr. 495, i datës 16.03.2021, i lëshuar nga Shkolla e Mesme Profesionale “Bahri Haxha” në Vushtrri, për ditët e punës së paditëses F.B, ka vërtetuar që gjatë periudhës kohore nga data 15.07.2019 e deri me datë 15.03.2021, ka pasur 295 ditë pune, nga të cilat 245 ditë në vendin e punës dhe 50 ditë të tjera mësim online pa qenë në vendin e punës (në periudhën 16.03.2020 e deri më 29.05.2020) dhe 245 ditë në vendin e punës shumëzuar për vlerën prej dy (2) euro në ditë për shujtën ditore, rezulton se detyrimi i të paditurës ndaj paditëses F.B, në emër të kompensimit për ushqimin ditor-shujtave në punë, të jetë në shumën pre 490.00 euro.

Duhet theksuar se detyrimi i të paditurës ndaj paditëseve është i bazuar edhe me nenin 8.1 të Ligjit nr. 04/I-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), është përcaktuar që *“Pjesëmarrësit në marrëdhënien e detyrimit kanë për detyrë ta përmbushin detyrimin e vet dhe janë përgjegjës për përmbushjen e të njëjtit”*, kurse me nenin 245 të LMD-së është paraparë që *“Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij”*, e që në këtë rast e paditura është e detyruar që të përmbushë një detyrim ndaj paditëseve, ashtu siç është vendosur në dispozitivin I të këtij aktgjykimi.

Në anën tjetër për gjykatën nuk mund të qëndroj pretendimi i të paditurës se pasi që ajo nuk ka qenë nënshkruese e Kontratës Kolektive, asaj i mungon legjitimiteti pasiv në këtë çështje. Kjo ngase në radhë të parë e paditura është punëdhënësi i paditëseve dhe të njëjtit janë në një raport kontraktual të marrëdhënies së punës e po ashtu faktit se KKA-ja është e lidhur në nivel vendi, me efekt të zbatueshëm në të gjithë Republikën e Kosovës. Lidhur me këtë, me nenin 90, par 2.1 të Ligjit nr. 03/L-212 të Punës, është paraparë që *“Marrëveshja Kolektive mund të lidhet në nivel të vendit”* dhe mbi këtë bazë kërkesëpadia e paditëseve është e bazuar në Kontratën Kolektive të Arsimit nr. 2056, e datës 18.04.2017, konkretisht Kontratën Kolektive nr. 105, e datës 22.01.2021, të lidhura në mes Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) në njërën anë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës (SBASHK) në anën tjetër.

Për gjykatën është i pabazuar edhe kundërshtimi i të paditurës se kërkesëpadia e paditësve është e parashkruar sepse me nenin 87 të Ligjit e Punës, është përcaktuar se *“Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”*, kurse në rastin konkret paditësit për kompensimin e shpenzimeve të ushqimit-shujtave për ditët e kaluara në punë që përfshinë periudhën kohore nga data 15.07.2019 e deri me datë 15.03.2021, e kanë paraqitur padinë më datë 27.05.2021, pra kërkesat e paditëseve për

kompensim janë brenda afatit ligjor sepse nuk e kanë kaluar afatin prej tre vitesh ashtu siç përcaktohet me nenin 87 Ligjit të Punës dhe nuk janë parashkruar.

Gjykata përveç kërkesës kryesore, duke u bazuar në dispozitën e nenit 382 par.2 të LMD-së dhe Mendimin juridik për kamatën i Gjykatës Supreme të Kosovës, nr. 265/2020 i datës 02.12.2020 paditëseve i'a njohu edhe të drejtën në kamatë ligjore, në lartësi prej 8% në vit, duke llogaritur nga data 27.05.2021, si dita e paraqitjes së padisë në këtë gjykatë e deri në pagesën definitive.

Gjykata ka marrë vendim sikurse në dispozitivin II, të këtij aktgjykimi me të cilin ka refuzuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditësve sepse sipas Vërtetimeve për ditët e punës së paditësve të lëshuara me datë 16.03.2021 nga Shkolla e Mesme Profesionale "Bahri Haxha" në Vushtrri, të cilat vërtetime janë përshkruar më lartë për secilin nga paditësit, të njëjtit gjatë periudhës kohore nga data 16.03.2020 e deri më 29.05.2020, kanë pasur vetëm nga 50 ditë online, të cilat ditë të punës kanë qenë gjatë periudhës së pandemisë Covid-19. Pra ditët e punës online të paditësve janë mbajtur pa dalë në vendin e punës. Prandaj duke u bazuar në nenin 35.7 të KKA-së, sipas të cilit thuhet "*Të punësuarve, u sigurohet kompensim për ushqime gjatë punës, për ditët e pranisë në punë...*". Gjykata ka arritur në përfundim se lidhur me këtë periudhë kohore për të cilën është kërkuar kompensimi dhe paditësit kanë pasur vetëm mësim online (secili nga 50 ditë pune), duhet të refuzohet kërkesëpadia e tyre sepse të njëjtit për këto ditë kanë pasur vetëm mësim online, pa qenë prezent në vendin e punës dhe për këtë arsye as nuk mund t'i njihet kompensimi për shujtën ditore për ditët e pranisë në punë.

Lidhur me shpenzimet e procedurës si në dispozitivin III të këtij aktgjykimi, gjykata vendosi duke u bazuar në nenin 449 të LPK-së e po ashtu nenit 452.2, të LPK-së sipas të cilit përcaktohet që "*Po që se paditësi vetëm pjesërisht ka sukses në procesin gjyqësor, atëherë gjykata mundet, duke marrë parasysh suksesin e arritur, të caktojë që secila palë t'i bartë shpenzimet e veta apo që njëra palë t'ia shpërblej tjetrës, dhe ndërhyrësit që i është bashkuar, pjesën proporcionale të shpenzimeve.*", ashtu e paditura duhet që paditëseve të ia paguaj shpenzimet e procedurës dhe atë për përpilimin e padisë 312.00 euro dhe për taksën për padi shumë prej 40.00 euro, me vlerë të përgjithshme prej 352.00 euro. Pjesë e kërkesës për shpenzime të procedurës së paditësve ishin edhe 312.00 euro në emër të precizimit të padisë së datës 18.03.2024, por këto shpenzime nuk i'a ka njohur gjykata sepse ky precizim i padisë është bërë pas aktvendimit C.nr.648/21, të datës 04.03.2024, me të cilin gjykata i ka detyruar paditësit të plotësojnë padinë për pagesën e diferencës së taksës dhe që gjykatës t'ia dorëzojnë autorizimet origjinale për përfaqësim, prandaj nuk mund të detyrohet pala e paditur për shpenzime të cilat janë krijuar me fajin e vet paditësve.

Gjykata vendosi që këtë çështje kontestimore ta vendos jashtë seancës gjyqësore ashtu siç është përcaktuar me nenin 398 të LPK-së, e cila parasheh që: "*Kur gjykata, pasi t'i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit merititor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë*", ngase thëniet e paditësve lidhur me gjendjen faktike në padi për ditët e punës u vërtetuan me provat e propozuara nga të njëjtit, të cilat prova janë lëshuar nga institucionet arsimore të së paditurës, që nuk janë kontestuar as nga pala e paditur dhe në këtë mënyrë e bënë të themeltë edhe

kërkesëpadinë e paditëseve. Kurse fakti se e paditura e ka kontestuar kërkesëpadinë mbi bazën e legjitimitetit pasiv dhe parashkrimin nuk është pengesë për të marrë aktgjykim jashtë seance sepse ashtu siç u theksua më lartë, këto kundërshtime janë prezumime ligjore e jo rreth gjendjes faktike, e si të tilla janë të pabazuara.

Gjykata ka vlerësuar se marrja e aktgjykimit pa mbajtur seancë gjyqësore është në harmoni edhe me praktikën e ndërtuar nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ), e cila praktikë është obligim që të zbatohet nga Institucionet e Republikës së Kosovës. Kjo duke u bazuar në nenin 53 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, ku thuhet se *“Të drejtat njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut”*.

Në rastin [Jussilia kundër Finlandës](#), nr.73053/01, pika 41, GJEDNJ ka konstatuar se mund të ketë procedura gjyqësore në të cilat mund të mos mbahet një seancë dëgjimore, siç mund të jenë rastet kur nuk janë kontestuese çështjet e besueshmërisë ose fakteve dhe gjykatat mund të vendosin çështjen në mënyrë të drejtë dhe të arsyeshme vetëm në bazë të parashtrësive të palëve dhe materialeve tjera të shkruara, e po ashtu në rastin [Saccasia kundër Austrisë](#), nr.69917/01, pika 76, është konstatuar se GJEDNJ ka vlerësuar se mos mbajtja e seancës gjyqësore mund të justifikohet në rastet që ngrenë apo kontestohen thjesht çështje ligjore të një natyre të kufizuar.

Prandaj, duke u bazuar në nenin 398 të LPK-së dhe praktikën e GJEDNJ-së, përderisa e paditura në kundërshtimet e saj me përgjigje në padi ka kontestuar vetëm çështje materiale-ligjore, siç janë parashkrimi dhe mungesa e legjitimitetit, sipas vlerësimit të gjykatës mbajtja e seancave gjyqësore është e panevojshme, ndërsa vendosja lidhur me çështjen si në dispozitiv të këtij aktgjykimi ka mundur të realizohet mjaftueshëm edhe jashtë seance vetëm përmes shkresave të lëndës.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI  
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL  
2021:102665, C.nr.648/2021, me datë 29.04.2024**

**G j y q t a r i**

**Leotrim Gashi**

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditësh, pas ditës së pranimit të të njëjtit, përmes kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit të Kosovës, në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.